Autori:
Lebit Murtishi

Redaktor:
Zekë Krasniqi

Përgatitja kompjuterike:
Kadri Sherifi

Kopertina:
Kadri Sherifi

Shtypi:

Tirazhi: 1000 copë

Lebit Murtishi

Pelegrinë

Në

Janinë

(poezi)

cikli i parë

I

„përtype të shkretën fjalë”

1) *Shqipëri!*
2) Pelegrinë në Janinë
3) Çamëri!
4) Mermëni udhëtarë...
5) Atdhe
6) Vendnumërim!
7) Buzëqesh Pranverë
8) Këngë lulesh
9) I dua lulet
10) Mallkim mbi Kosovë...

Shqipëri!

Mos thuaj
se s` më ke bir,
mos thuaj
se s` më ke djalë,
Përtype
të shkretën fjalë
se më dhemb
ky Shpirt i vrarë…

Mos thuaj
se më ke fqi
edhe në s` më mer në gji,
Përtype
të shkretën fjalë
se më dhemb
ky Shpirt i vrarë…

08.03.2006
Bern

Pelegrinë në janinë...

mot për mot
njëherë shkoni
pelegrinë në janinë,
shkoni
varret numëroni
në çdo kodër
e lëndinë…

shkoni Ooo…
njëherë në mot
pa bërë kujë
e pa lot,
se lëndoni kapedanë
që pushojnë mbi jataganë…

shkoni
një grusht ujë pini
në krojet e çamërisë,
shkoni
mu në mesolongji 1)
ku fle nderi shqipërisë…

Tek pashai
mos marroni
ngjeshur jataganë të shkoni,
zgjo taborët të m` i thoni,
jemi Shqipëria thoni...

15.06.2006
Bern

1) Vend ku është varrosur heroi Marko Boçari

Çamëri!

Mos rënko
kaq me dënesë
shpresë e lodhur n` ëndërrim
gjersa i fundit
bir të mos vdesë
do jesh dhè i dheut tim…

25.05.2006
Bern

Merrmëni udhëtarë...

Ju udhëtarë
të paqes së brishtë
me ëndrrën diellore në duar,
merrmëni,..
mermëni të dëgjoj
këngën e trishtë
të palcës së tokës së bluar…

merrmëni…
pelegrinë të lodhur
të paqes së brishtë,
merrmëni.
Mes malesh me yje të flaktë
më çoni
që vdekjen ta pres shqiptarisht…

25.06.2006
Bern

Atdhe

S` mjaftoi Berlini,
as Londra s` qe mjaftë
egërsisht prêt trungun
tash Vjena e lashtë.

n` emër tënd kosovë
ca horra kokëtrashë
varret e Prizrenit
po t` i hedhin jashtë…

këndellu Kosovë,
thuaj ç` emër ke,
ti veç Shqipërisë…
tjetër nënë s` ke…

31.05.2006
Bern

Vendnumërim !

Kohët shkelin
njëra-tjetrën
ora jonë
mat vetveten…

01.01.2000
Bern

Buzëqesh pranverë

Për këngët që këndohen
në kopshte dashurishë,
për trimat që qëndrojnë
në ballë të shqipërisë…

për lulet që po çelin
të kuqe shesh më shesh,
për trimat_lapidarë
pranverë buzëqesh…

08.03.2006
Bern

Këngë lulesh

Qeshi oxhaku,
qeshi
dhe kënga
në djep t` ajkunës.

Në dallgë zjarresh
linden
nga hiri
bij të fortunes…

…qeshi pranvera
me këngë lulesh…

12.06.2006
Bern

I dua lulet

i dua lulet
që lidhin rrënjët
në rrënjë guri
shtatin në rrudhat
e shkëmbit…

i dua lulet
që erë e ngjyrë
i kanë të flamurit.

27.06.2006
Bern

Mallkim mbi kosovë

Që kokërr gruri të mos mbijë
Që pike uji mos pikojë
Që ylli shpresës mos vallëzojë
Që dielli most ë diellzojë
Që hëna kurrë qilim mos shtrojë…

Po grur i ri pranverën zgjoi
Dhe pikë e shiut lumë shkoi
Dhe yll i shpresës vallëzoi
Dhe dielli ëndrrat diellzoi
Dhe hënë e plotë qilima shtroi…

26.06.2006
Bern

cikli i dytë

II

„baladë pylli”

1) *Tinguj të vendlindjes*
2) Baladë pylli
3) Lirikë malli
4) O e shanjta ime gurrë...
5) Në krastën time
6) Ti këngë Frëngove 1)
7) Shpirti im udhëtar...
8) Psherëtimë
9) Ladorisht

Tinguj të vendlindjes

Lermëni,
bri këtij shkëmbi
lirika dhimbjesh
sott ë mbledh…

lermëni,
këngën e malit
damarëve
te ndiej thellë…

lermëni,
tek ky burim
nën këngën
e shenjtë të malit…

lermëni,
këtu mes lulesh,
lermëni
të vdes prej mallit…

prill - 2006

Baladë pylli

Mes pyllit të egër
unë shkoj
dhe zëra baladash dëgjoj,
të zhurmët
pranverën e ndiej
në këngët e çdo përroi…

mes pyllit të egër
me ferra
sa udhë të lashta janë zënë,
s` e ndiej më
kollën e pleqëve
as hijen e tyre të rëndë…

mes pyllit të egër
pa udhë
unë shkoj balada të mbledh
ndër shtigje të mbyllur,
pa gjurmë
ku pleqtë e moçëm kanë shkelë…

dhe zgjohen
kujtimet e brishta
kur ujë me grusht pi në lumë,
dhe shkoj mes pyllit pa udhë
nën qiellin e mbushur – furtunë…

16.06.2006
Bern

Lirikë malli

I rashë malit
mes përmes
pyll më pyll
e shteg më shteg,
pa njüë cak
si zog pa fletë
ku më çonte
malli vetë…

Putha kroje,
gurë, drurë,
putha shtigje,
putha gjurmë,
putha lule manushaqe,
putha lotin tim në faqe…

O shpresë
e rilindur,
O agimi im i artë!
puthma këtë lot në faqe,
puthma këtë lot të zjrrtë…

13.04.2006
Bern

O e shenjta ime gurrë...

lejomë
pak ujë të pi,
jam udhëtar
i mbetur n` udhë,
lejomë
me grusht të pi
o e shenjta ime gurrë…

lejomë
o ime gurrë,
jam udhëtari
zemërgur,
lejomë të kem fëmijë
t` ia them këngës si dikur…

06.06.2006
Bern

Në krastën time

i prek me dorë
gurët e lashtë të bardhë,
i prek e i puth me radhë
si copë guri
që jam…

dhe flas me gurët
në krastën e lashtë të bardhë,
unë,
që gjuhë e zemër
nga ato gurë
i kam…

22.06.2006
Bern

Ti këngë frëngove 1)

Në keni mall
për krojet e lashtë
të këngës së moçme pleqërishte
dhe sofrën e shtruar
Bujarisht;

në keni mall
për këngën me nëntë
dhe fjalën e dhënë
trimërisht…

…dhe në heshtë istoria
si ç` ka heshtur dymijë vjet
" Është Jona Shqipëria" 2)
do t` ia thotë Frëngova vet…

24.06.2006
Bern

1) frëngova – fshat në rrethin e strugës
2) këngë që i kushtohet ismail qemalit

Shpirti im udhëtar...

O tinguj të magjishëm
të vendit tim krenar
gjëmoni sot furishëm
për shpirtin tim udhëtar…

O male të vendlindjes
të Shpirtit tim udhëtar
në vdeksha sot prej dhimbjes
askush të mos më qajë…

Askush asgjë mos thotë
për kohgën që m` u tret
se rrugëve të botës
unë mjaft kam qarë vet…

25.05.2006
Bern

Psherëtimë

E ndiej malin
si mer frymë,
e ndiej dallgën
si rënkon…

e ndiej gjethin
si vdes nën brymë
dhe psherëtimën
që lëshon…

29.05.2006
Bern

Ladorisht

Jam yt bir
o Shenjti im,
udhëtar i pakufi,
sado largë
ne të dy
Ti je unë,
unë jam Ti…

06.06.2006
Bern

cikli i tretë

III

„këtu dhimbja pagëzohet”

1) *Pas kohës...*
2) Jam udhëtar...
3) Në mesrrugë...
4) Paradoks
5) Mërgim
6) Këngë e erës
7) Bie borë...
8) Sytë e vdekjes...
9) Urti
10) Ky Mister...
11) Enigmë!
12) Këngë diellore
13) Det!
14) Këngë e kavallit!
15) S` mërzitem
16) Ç` udhë të marr...
17) Është poezi kjo...

Pas kohës

pas kohës së mbetur
vrapoj,
drejt erës së çmëndur
një shteg të ri
kërkoj;

Vrapoj pas ëndrrës së lashtë,
se s` dua,
as gjallë as vdekur
nën hije kufomash të rroj...

24.06.2006
Bern

Jam udhëtar...

pikë loti
jam
n` oqeanin e dhimbjes paanë,
shtruar jam në sofrën e mallit,
mbështetur
në ëndrrën e bardhë...

pikë loti
jam
në udhët qiellore paanë,
kam Shpirtin të mbushur me zjarrë
unë kokëkrisuri
i marrë...

02.06.2006
Bern

Në mesrrugë...

S` jam pranverë
e perënduar
as jam zjarr
as hi i shuar;

as thëngjill
nën hi i mbetur
as qiri
nën flakë tretur...

në mesrrugë
jam i lënë
gjysma Diell
gjysma Hënë...

27.06.2006
Bern

Paradoks

Ecim pranë të tjerëve
bëjmë sikur nuk shohim,
ecim pranë mjerimit
të mjerin s` e njohim...

pranë vehtes ecim
vehten e kërkojmë,
veç përballë pasqyrës
rrugën e dredhojmë...

19.03.2005
Bern

Mërgim

Këtu
s` këndohen
këngë të moçme
as krisma pushkësh
s` dëgjohen...

këtu lindin fëmijë
e nuk pagëzohen!

Këtu
shpatë e fatit
në palcë farkëtohet,
këtu,
veç dhimbja pagëzohet...

02.06.2006
Bern

Këngë e erës

Jam këngë e erës
lindur në dallgë,
jam bir furtune
me hap të zjarrtë...

Jam këngë guri
nga gjoksi i malit
kam ngrënë me lotë
bukën e mallit...

Jam këngë gjëmimesh
të tokës mëmë
ndaj pres i lumtur
të vdes më këmbë...

29.05.2006
Bern

Bie borë...

Bie borë
në sytë e mi
si dikur
në fëmini...

Më perqesh
këngë e natyrës
pse më zbret
një lot fytyrës...

08.03.2006
Bern

Sytë e vdekjes...

përgjojnë
sytë e vdekjes
këngët
në pranverë që bulëzojnë
dhe rrugët kah dielli që çojnë.

sërgjojnë
sytë e vdekjes
me barrën e rëndë të urrejtjes...

15.09.2000
Bern

Urti

loti është
pasqyrë e Shpirtit
dhe
stoli e Hipokritit...

01.01.2000
Bern

Ky Mister...

Kjo ëndërr
s` më le të shqitem
nga fijet e hershme të jetës,
Ky mister
i besdisshëm
do më ndjekë
gjer buzë vdekjes...

15.11.2000
Bern

Enigmë!

qava shumë sot,
ndoshta nesër
Qesh
nëse më le vdekja
në këtë Kohë-Lesh...

29.08.2000
Bern

Këngë diellore

Ti,
do të vish
o këngë diellore;
e kuqe,
e zjarrtë
e me nder,
ti,
do të vish
o këngë e artë
me agun e parë
në Pranverë...

14.06.2006
Bern

Det!

Në sa limanë
kjo peshë malli
shperndan dhimbjen
sot
o Zot...

Det i kaltër
furtunë ëndrrash
reh me valë
gjokse nënash...
Det
o Det...

09.04.2006
Durrës

Këngë e kavallit!

Ulërimë Shpirtërore
nga fund-ferri
sikur vjen,
agoninë njerëzore
këngë dhimbjesh
e ushqen...

08.03.2006
Bern

S` mërzitem...

s` mërzitem
që m` i shajnë këngët.

S` mërzitem që thyejnë dhëmbët
ata që në vend të kokës
mbi jastëkë mbajnë këmbët...
s` mërzitem!

27.06.2006
Bern

Ç` udhë të marr...

Në zemrën tënde
që të vi
ç` udhë të marr
nuk e di...

Të vi me këngë
si Orfe!
apo i shkrehur
si rrufe...

Nuk e di
ç` udhë të marr
por do të ndjek
edhe nën varr...

13.04.2006
Bern

Është poezi kjo...

Dy sy
të qeshur
nga zjarri parë...

dy yj
të ndezur
nën qiell të larë...

thëngjill
i heshtur
mbetur nën hi...

kujtesë
e largët
që ther në gji...

06.06.2006
Bern